

A dëshiron që të punosh në një lëmi që tërë kohës është në ndryshim e sipër?

A dëshiron që të punosh ose studiosh në shtete thera?

A dëshiron të kërkosh punë menjëherë pas gjimnazit?

A dëshiron që të keshë mundësi të krijosh sipërmarrjen tënde në ardhmëri?

A dëshiron të punosh me diçka që ndikon pothuajse tërë shoqërinë tonë?

Në atë rast, Programi elektrik mund të jetë për ty.

Te Programi elektrik të jepet mundësia që të mësosh bazat e një lëmie në ndryshim e sipër. Mendo se sa shumë ndikohet jeeta yte në përgjithësi në lidhje me rrymën! Atëherë do të kuptosh se sa e gjerë është lëmia. Kështu që ju keni mundësi të mëdha që shkollohesh në një kulifikim që të përshtate pikërisht ty. Njëkohësisht që të jepet mundësia të bashkëpunosh me të tjerët. Do të mësosh gjërë që janë themelore për lëminë tënde, si për shembull siguri, precizion dhe menyrë mendimi të shërbimeve.

Me Programin e elektrik si bazë do të mund të punosh në pothuajse tërë notën. Mund të zgjedhësh të kërkosh punë menjëherë pas gjimnazit, ose të vazhdosh studimet.

Të punosh apo t'i vazhdosh studimet

Nëse zgjedh Programin e elektrik mund të kërkosh punë menjëherë pas gjimnazit. Llojet e punëve ku mund të pranohesh varren nga drejtimi që e ke zgjedhur. Në disa raste të jepet mundësia që të fillimisht të punosh si çirak gjatë një viti apo gjatë disa viteve. Në atë rast të marrësh rrogë çiraku dhe do të jepet mundësia të punosh së bashku me persona që janë të punësuar në lëminë tënde që të mësosh prej tyre. Ato kanë dituri të posaçme dhe kanë përvojë pune të gjatë.

Nëse dëshiron mundesh edhe t'i vazhdosh studimet pas gjimnazit. Të gjitha drejtimit e Programin elektrik të japin mundësi të mira që t'i vazhdosh studimet. Mund të studiosh në fakultet ose të zgjedhësh një kulifikim tek Fakulteti i profesioneve ose në një kulifikim i lëmisë.

Punë ku mund të pranohesh

Pasi që e përfundon Programin elektrik mund për shembull të kërkosh punë si elektriciist industrial, koordinues i PS-së, teknik i kompjuterëve, instalues elektrik, teknik i alarmëve, teknik i energjisë hidraulike ose montues i ashensorëve.

Nëse zgjedh të vazhdosh studimet pas gjimnazit, ke mundësi të mëdha që më pas të kërkosh shumë punë të llojeve të ndryshme. Persona me dituri elektrike nevojiten gjithkund në shoqëri.

Nëse që tani e di se me çka dëshiron të punosh, duhet të flaësh me udhërrëfyesin e studimeve dhe të profesioneve. Ajo apo ai mund të të ndihmojnë që të zgjedhësh kursin dhe drejtimin e duhur.

Përmabajtja e Programit

Programi elektrik përbëhet prej kurseve. Disa kurse janë obligatorike për të gjithë ata që studiojnë në gjimnaz. Kurse e tjera janë veçanta për Programmin elektrik. Disa nga kurset do të mund t'i zgjedhësh vetë.

Programi përbëhet prej katër drejtimeve ndërkombëtare. Kjo do të thotë se të gjithë ata që studiojnë në Programin elektrik në tërë vendin mund t'i zgjedhin drejtimet. Në disa vende mund të ketë edhe me tepër drejtime që ndoshta të përshtaten ty më së miri. Pyete udhërrëfyesin tënd të studimeve dhe të profesioneve.

Drejtimet kombëtare janë:

- Automaticizëm – për ty që për shembull dëshiron të punosh në industrinë precize dhe industrinë e prodhimeve, siç është tekniku i prodhimeve
- Teknik kompjuterësh - për ty që për shembull dëshiron të punosh në ndonjërin a nënëlmive të teknikës së kompjuterëve, me për shembull kooperim të PC-ve ose administrim të rrjetit
- Elektronik - për ty që për shembull dëshiron të punosh në shërbim dhe mirëmbajtje të produkteve elektrtonike ose në prodhime elektrtonike
- Teknik i elektrikut - për ty që për shembull dëshiron të punosh në lëminë e elektikut, me për shembull instalim të rrymës ose teknik a alarmeve.

Kontakte me tregun e punës

Te Programi elektrik do të kesh kontakte me tregun e punës që nga koha e gjimnazit. Do të keshë të paktën 15 javë kualifikim në vende të punës (APU). APU-në tënde e planifikon shkolla në bashkëpunim me vende të lira të punës aty ku banon ti. Do të jepet mundësia të keshë kontakte edhe me sipermarrës privat edhe me kompani të mëdha ndërtimi që gjinden në shumë shtete. Kjo është një mënyrë e mirë që të krijoni kontakte të cilat mund t'i përdorësh kur do të kërkosh punë. Nëse të intereson ta bësh APU-në tënd në një vend tjetër përveç Suedisë, kjo mundësi do t'ju jepet.

Ardhmëri dhe punë

Gjatë viteve të fundit ka pasur shumë nevojë për shumë punëtorë në të gjithë lëminë elektrikut. Por edhe shumica janë shkolluar që të mund të pranohen në punë në këtë lëmi. Për këtë arsye mund të jetë e vështirë për ty zgjedh të studiosh te Programi elektrik që të pranohesh në punë. Mundësitë e tua për punësim ndikohen shume edhe nga drejtimi tek programi që e zgjidhni edhe nga cialt kurse ti zgjedh që t'i shtosh kualifikimit. Lëmia mund të

ndryshojë shumë brenda një kohe të shkurtër dhe për këtë arsye është vërshtirë të themi se a do të jetë e lehtë apo e vështirë për ty që të pranohesh në punë pasi disa viteve.